REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBALIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS-MINISTARSTVO ZA KOSOVSKIH SNAGAMA BEZBEDNOSTI-MINISTRY OF KOSOVO SECURITY FORCE
ZYRA E SEKRETARIT TË PERHERSHEM-KANCELARIJA PERMANENTNOG SEKRETARA-OFFICE OF THE PERMANENT SECRETARY
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org.Unit 217 — Nr.Prot. / Bro.Prot. / Prot.No. 700
Nr i faqeve / Broj stranica / No.pages 3 — Data / Datum / Date 01/03/2013
Prishtinë / a II

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIJA ARHIVA-ARCHIVE OFFICE
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit 01 — Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 15
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages 03 — Data / Datum / Date 01/03/2013
PRISHTINË/A

**Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës**
Minstartsvo za Kosovske Snage Bezbendosti
Ministry for the Kosovo Security Force

**Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Përsonale**
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Personal Data Protection

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-45 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 26/2008), si dhe Neni 43 të Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Nr. 70 / 31 maj 2010).

# MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

## NË MES TË

## MINISTRISË PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

## DHE

## AGJENCISË SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

**Prishtinë, Shkurt 2013**

## Neni 1
## Palët Nënshkruese

1. Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, e cila përfaqësohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Shkëlzen Sylaj.

2. Agjencia për Mbrojtjën e të Dhënave Personale, e cila përfaqësohet nga Mbikqyrësi Kryesor Shtetëror, z. Ruzhdi Jashari.

## Neni 2
## Qëllimi

Ky memorandum mirëkuptimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pajtohen t'i realizojnë konform mandatit dhe kompetencave ligjore.

## Neni 3
## Fushat e Bashkëpunimit

1. Ministria për FSK-në dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të koordinojnë aktivitetet për realizimin e misionit të tyre të bazuara në ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

2. Ministria e FSK-së, në kuadër të aktiviteteve trajnuese, do t'i ofrojë Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mundësinë për trajnimin dhe certifikime të nëpunësve të tij në këto fusha:

   2.1.Standardet e sigurisë;

   2.2.Kurset e gjuhëve të huaja.

3. Ministria për FSK-në dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të përgatisin plan vjetor për realizimin e trajnimeve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni.

**Neni 5**
**Interpretimi dhe Ndryshimi**

1. Interpretimi i këtij memorandumi do të bëhet në pajtim me ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.

2. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.

**Neni 6**
**Kopjet e Memorandumit**

Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga dy kopje për secilën palë.

**Neni 7**
**Hyrja në Fuqi**

Ky memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

**P A L Ë T N Ë N S H K R U E S E**

| | |
|---|---|
| **Për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës** | **Për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale** |
| Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së<br>z. Shkelzen SYLAJ | Mbikqyrësi Kryesor Shtetëror<br>z. Ruzhdi JASHARI |
| ____________________ | ____________________ |

Nënshkruar në Prishtinë, më datë 01 mars 2013